



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPSHTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

DATE/A	07.05.2018
REFERENC-Ë :	
PËR/ZA/TO:	Imri Ahmeti, Kryetar i Komunes së Lipjanit
CC:	Fauz Xheaili - Nënkyetar i Komunës së Lipjanit
	Lulzim Qerimi - Nënkyetar i Komunës së Lipjanit
NGA/OD/FROM:	Shkelzen Hajdini, Drejtor i Drejtoratit për Ekonomi dhe Zhvillim
TEMA/SUBJEKAT/ SUBJECT:	Raport Mujor 01.04.2018 - 30.04.2018

Gjajtë muajit Prill 2018, të hyrat nga qeraja kanë shënuar rritje. Në krahasim me periudhën e njejtë të vitit të kaluar, inkasimi i të hyrave nga qeraja është më i madh për 97%.

Në krahasim me planifikimin vjetor të të hyrave për vitin 2018, plani vjetor i realizuar i të hyrave nga qeraja është 40%.

Trendi i realizimit të të hyrave nga qeraja është në rritje ngase për shumicën e lokaleve afariste në pronësi të komunës Asambleja Komunale ka marrë vendim paraprak për dhënje në shfrytëzim afatshkurtër me qëllim të rritjes së të hyrave komunale.

Bazuar në Ligjin Nr.04/L-144, Rregulloren QRK NR. 23/2013 dhe në Njoftimin për pjesëmarrje në ankand publik Nr. 15-463-14533 për dhënje në shfrytëzim afatshkurtër të lokaleve afariste në pronësi të Komunës, të shpallur më 12.03.2018, komisioni vlerësues për dhënje në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të Komunës së Lipjanit, në përbërje të plotë prej 7 anëtarëve, ka mbajtur ankandin publik në Sallën e Kuvendit Komunal më 11.04.2018 në ora 10:00.

Më 30.04.2018, Asambleja Komunale ka aprovuar Propozim Vendimin paraprak për dhënjen në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të Komunës së Lipjanit, respektivisht dhënjen e katër lokaleve afariste për partitë e interesuara politike. Cmimi i caktuar nga kuvendi komunal për një metër katrorë në këtë seancë është 0.20€. Për zbatimin e procedurave për dhënjen e lokaleve afariste për partitë e interesuar politike, Zyra Lipgjore e Komunës së Lipjanit ka marrë interpretim ligjor nga MAPL, ku i njejtë thekson se duhet të zhvillohen procedurat e ankandit publik.

Poashtu, në këtë mbledhje, Asambleja Komunale ka votuar Propozim Vendimin për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit për hartimin e projektit të Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal të Komunës së Lipjanit për periudhën 2018-2023.

Organizata Help në kuadër të projektit “Mbështetje stabilitetit socio-ekonomik në rajonin e Ballkanit Perëndimor 2017-2018” ka vizituar aplikantët e përzgjedhur në listën e shkurtër. Mbas fazës së vizitave, do të aprovohet lista përfundimtare e përfituesëve dhe do të ftohen përfituesit e granteve për nënshkrim të kontratave me Organizatën Help.

Me 18.04.2018, grupi punës i formuar për projektin “Përmirësimi i Klimës së Investimeve II përmes thjeshtimit të procedurave administrative” ka marrë pjesë në takim të parë informues të organizuar nga International Financial Cooperation IFC World Bank Group. Në takim, anëtarët e grupit punës janë njoftuar rreth projektit me theks të veçantë rreth licencave, lejeve si dhe dokumenteve tjera për të cilat do të provohet të lehtësohen procedurat.

Me qëllim të inicimit të procedurave të prokurimit, janë zotuar mjetet në vlerë prej 68,725.51 € për bashkëfinancimin e projektit "Tregu i gjelbër" të cilin Komuna e Lipjanit e ka përfituar nga Ministria e Zhvillimit Rajonal. Drejtoratet kompetente do të vazhdojnë me procedurat që pasojnë dhe menagjimin e punëve deri në përfundim të projektit.

Komisioni vlerësues i formuar nga Kryetari i Komunës, i përbër edhe nga përfaqësuesit e UNDP-Projekti ReLOaD ka bërë vlerësimin e aplikacioneve të pranuar nga OSHC-të për thirrjen ReLOaD e cila ka për qëllim mbështetjen e OSHC-ve.

Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim ka informuar Sekorin Pronëso- Juridik për pagesën e qerave, bazuar në kontratat e lidhura për lokalet dhe pronat tjera komunale. Sekori Pronëso- Juridik informohet në baza të rregullta mujore.